

**V E N D I M**  
**Nr.443, datë 16.7.1998**

**PËR KRIJIMIN E AGJENCISË KOMBËTARE TË ENERGJISË**

Në mbështetje të nenit 36 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Krijimin e Agjencisë Kombëtare të Energjisë si person juridik, publik, buxhetor, me seli në Tiranë, në varësi të ministrit përgjegjës për energjinë.

2. Objekti i Agjencisë Kombëtare të Energjisë është:

- Të shërbejë si organ i specializuar për ministrin përgjegjës për energjinë, për problemet që lidhen me strategjinë dhe politikën në fushën e energjisë.

- Të kryejë analizën dhe vlerësimin e skenarëve të ndryshëm energjetikë, të bëjë parashikime dhe të propozojë plane veprimesh për përdorimin racional të energjisë, për përdorimin e energjisë për popullatën dhe për përdorimin e formave të reja të energjisë.

- Të mbledhë dhe të sistemojë të dhënat që kanë të bëjnë me prodhimin, furnizimin dhe konsumin e energjisë në të gjithë sektorët e ekonomisë, si banesa, industri, transport, shërbime, bujqësi etj.

- Të përgatisë dhe të publikojë një informacion vjetor për zhvillimet në fushën e energjisë.

- Të përgatisë në çdo dy vjet një vlerësim të shkallës së zbatimit të strategjisë kombëtare për energjinë, si dhe prognoza të kërkesës dhe ofertës për periudha jo më shumë se 5-vjeçare.

- I propozon ministrit projektaktet e nevojshme, ligjore e nënligjore, për plotësimin e legjislacionit në këtë fushë.

3. Agjencia Kombëtare e Energjisë drejtohet nga kryetari i saj dhe nga një këshill drejtues prej 5 anëtarësh. Anëtarët e këshillit drejtues, si dhe kryetari i këtij këshilli emërohen nga ministri përgjegjës për energjinë. Strukturat dhe rregullat e funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Energjisë përcaktohen në statutin e Agjencisë, i cili miratohet nga ministri përgjegjës për energjinë.

4. Paga e kryetarit të Agjencisë njehsohet me pagën e zëvendësministrit, sipas pikës 3 të lidhjes III/5 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.213, datë 28.3.1998. Shpërblimi i anëtarëve të këshillit drejtues për pjesëmarrjet në mbledhje të njehsohet me atë të anëtarëve të këshillave mbikëqyrës të shoqërive tregtare.

5. Mjetet kryesore, objektet, mjediset, pajisjet, dokumentacioni, fondet buxhetore dhe vlerat e tjera monetare të Komitetit Kombëtar të Energjisë dhe Agjencisë së ngrohjes së popullatës, i kalojnë Agjencisë Kombëtare të Energjisë.

6. Të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga marrëveshjet ekzistuese, të lidhura me palë të treta nga Komiteti Kombëtar i Energjisë dhe Agjencia e ngrohjes së popullatës, sipas përcaktimit të ministrit përgjegjës për energjinë, i kalojnë Agjencisë Kombëtare të Energjisë ose ministrisë përgjegjëse për energjinë.

7. Vendimet nr.356, datë 18.8.1992 “Për krijimin e Komitetit Kombëtar të Energjisë”, nr.501, datë 18.10.1993 “Për miratimin e statutit të Komitetit Kombëtar të Energjisë” dhe nr.374, datë 26.7.1993 “Për krijimin e Agjencisë ekzekutive të burimeve energjitike për popullsinë”, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI  
**Fatos Nano**